

VENDIM
Nr. 166, datë 9.3.2012

PËR PËRFUNDIMIN E GJENDJES SË EMERGJENCËS CIVILE (FATKEQËSISË NATYRORE) NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE NË QARQET SHKODËR, KUKËS, DIBËR, KORÇË DHE NË RRETHIN E LIBRAZHBIT

Në mbështetje të nenit 100 e 174 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 2 shkronja “c” e 6 pika 3, të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfundimin e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore), si rezultat i përmirësimit të kushteve natyrore të motit, në njësitë e qeverisjes vendore në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe në rrethin e Librazhdit.

2. Përfundimin e veprimtarisë së Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha